



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za žalbe i Predstavke

Anr. 327/2019

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesuese, Adnan Konushevci dhe Faton Ademi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares së lartë ligjore Antigona Murati, duke vendosur lidhur me ankesën e Rrjetit Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN) dhe Interneës Kosova (IKS), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të vendosjes se postereve në afërsi të qendrës së votimit 100metra, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 06.10.2019, në seancën e panelit të datës 07.10.2019, mori këtë:

### V E N D I M

**Pranohet** e bazuar ankesa Anr.327 e datës 06.10.2019, të paraqitura nga Organizata Joqeveritare BIRN dhe Interneës Kosova, me seli në Prishtinë, dhe subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të vendosjes së posterëve në afërsi të qendrës së votimit 100 metra i shqiptohet gjobë, në lartësi prej 1.500.00 ( njëmijë e pesëqind) euro, , të cilën shumë, subjekti politik detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të këtij vendimi **nën kërcënim të përmbarimit**.

### A r s y e t i m

Parashtruesi i ankesës, Rrjeti Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN) dhe Interneës Kosova (IKS), me seli në Prishtinë, me datën 06.10.2019, ka parashtruar ankesë në PZAP, me të cilën pretendohet se me datë 6 Tetor 2019, në afërsi me pak se 100 metra afër Qendrës së Vendvotimit, shkollës fillore “Zenel Hajdini”, mund të shihet, poster i kandidatit për deputet Adem Salihaj, nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK). Më këtë rast pretendohet se një gjë e tillë bie ndesh me Ligjin e Zgjedhjeve, rregullat zgjedhore dhe Kodin e Mirësjelljes së partive politike të cilat të cilat qartazi parashohin se 24 orë para zgjedhjeve, të gjitha materialet/posteret propagandistike duhet të hiqen në rast se ndodhen në afërsi prej 100 metrave nga ndonjë Qendër e Vendvotimit.

Në përgjigjen në ankesë subjekti politik, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) konsideron se ankesa e BIRN dhe IKS është e pabazuar, për faktin se ka ushtruar ankesë me një fotografi të vetme me arsyen se është afër një shkollë por në anën tjetër nuk tregojnë saktë dhe në mënyrë të besueshme se cila është distancë e kësaj fotoje nga shkolla. Sipas subjektit politik LDK, në përgjigjen e tij thekson se distanca e fotos nga shkolla është më e madhe se 100 metra nga hyrja e shkollës, meqë hyrja përcaktohet si pika nga e cila duhet të bëhet matja e distancës. Më tutje thekson se ankuesi nuk ka treguar se nëse shkolla ka shërbyer si Qendër e

Votimit në ditë zgjedhjeve, po ashtu nuk dihet se fotoja a a është bërë në ditën e zgjedhjeve ose jo.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të bazueshmerisë së ankesës dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore si dhe provave materiale-fotografit, të bashkangjitura, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenin 117 par.2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se: **Ankesa është e bazuar**

Paneli, nga fotografia e ofruar si provë nga paraqitësi i ankesës, e cila gjendet në shkresat e lëndës shihet qartë se poster i kandidatit për deputet Adem Salihaj, nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), ka qenë i vendosur në shtyllën mbajtëse të pllakadave, afër shkollës ‘Zenel Hajdini’ në Ferizaj, njëherit QV, për ditë të votimit, veprim ky që është në kundërshtim me nenin 36 par.1, pika a) dhe b), të LZP-së, e cila përcakton se: “Njëzetekatër (24) orë para hapjes së qendrave të votimit për hedhjen e votës, e deri në mbylljen e tyre, subjekteve politike, mbështetësve ose kandidatëve të tyre u ndalohet secili prej veprimeve si më poshtë: a) Shpërndarja ose shfaqja në mënyrë tjetër në ndonjërin nga qendrat e votimit ose 100 metra brenda hapësirës së të njëjtës, e çfarëdo lloj materiali me qëllim ndikimi tek votuesit; b) Bërja e fushatës në çfarëdo mënyre”. Kjo është në kundërshtim me nenin si dhe nenit 85 paragrafi 1 i LZP-së, parashihet që 24 orë para fillimit të votimit të gjitha subjektet politike të cilat nuk kanë larguar materialet e fushatave të tyre zgjedhore të vendosura brenda dhe rreth cilido vendvotim ose qendre të votimit në rreze prej 100 metra, duhet të largohen nga anëtarët e KKV-ve, ose Menaxheri i QV-së, dhe se subjektet politike të cilat nuk i kanë larguar ose janë gjetur duke postuar do të raportohen në PZAP për shkelje të këtij ligji.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Nga arsyet e theksuar më e duke bazuar nenin 118 par.1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

Anr.327/2019 më datën 07.10.2019

Kryesuese e Panelit

Gyltene Sylaj



**Këshilla Juridike:** Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së